



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421 201; Fax 033 421 205 E-mail: info@vlora.gov.al

Nr. 2357 Prot.

Vlore 23.03 2017

**Drejtuar: Znj. Adelina GRECA
Drejtoare e Përgjithshme
Agjencia Kombetare Planifikimit të Territorit Tiranë**

LENDA: Kërkesë për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për draftin e PPV për Bashkinë Vlorë.

E nderuar znj. Greca,

Duke shprehur konsideraten për bashkëpunimin e suksesshëm dhe të vazhdueshëm midis të dy institucioneve dhe:

Mbështetur ne ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015 date 09.07.2015 dhe VKM nr. 671 datë 29.07.2015, nismës së Kryetarit të bashkisë me Vendim nr. 34 date 20.11.2015 dhe Vendimit të Keshillit Bashkiak nr. 40 date 16.12.2015, marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Vlorë dhe Konsulentit "Dea studio & Thimio Papavannis associates" për: "Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për bashkitë Vlorë, Himarë, Sarandë, Konispol" me nr. 2024/2 prot. datë 13.04.2016 si dhe në kuadrin ligjor mjedisor përkatës.

Ju njoftojme se Bashkia Vlore ka përfunduar procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Nga dita e sotme datë 23.03.2017 është publikuar në regjistrin elektronik të integruar të territorit (R.I.T.), i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në kuadër të procedurës përfundimtare të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë. Ky dokumentacion është përgatitur me profesionalizem nga konsulenti "Dea studio & Thimio Papavannis associates" në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Bashkisë Vlorë duke pasur parasysh

të gjitha kriteret e nevojshme për të realizuar këtë Plan të Përgjithshëm Vendor i cili do të jetë nje udhëzues me rëndësi per territorin tonë.

Për sa më sipër duke u bazuar te ligjshmëria në fuqi, kërkojmë nga autoriteti Juaj të hartoni shkresën që përmban Aktin e Përputhshmërisë së draftit të Planit të Përgjithshëm Vendor, në mënyrë të tillë që Bashkia Vlorë pas marrjes së këtij Akti të përcaktojë sipas procedurës datën per shqyrtimin dhe miratimin e këtij Plani në Këshillin Bashkiak.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj.

Me respekt.

KRYETARI

Dritan LELI

